



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:014992

Datë: 17.12.2024

Numri i dokumentit: 06614426

A.nr.113/23

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Fllanza Hashani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses D.S.T me vendbanim në fshatin Staradran, Komuna e Deçanit, kundër të paditurës Ministria Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve, me bazë juridike “anulimi i vendimit”, pas seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik, të mbajtur në mungesë të palëve ndërgjyqëse, më dt. 03.12.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses D.S.T, me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi me nr.2207 i dt. 06.12.2022 i të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve- Departamenti i Pensioneve dhe paditëses ti miratohet kërkesa për njohjen e të drejtës në pensionin paraplegjik dhe tetraplegjik në Grupin e I-rë, nga dita e paraqitjes së kërkesës.

II. Secila palë bart shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Gjykata me dt.03.12.2024 ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor në këtë çështje juridike e cila është mbajtur, në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në mungesë të palëve ndërgjyqëse, të ftuara në mënyrë të rregullt.

Paditësja në padinë e ushtruar pranë kësaj Gjykate më dt.18.01.2023, ka theksuar më 09.08.2022 ka parashtruar kërkesë për njohjen e të drejtës në kompensim për persona paraplegjik dhe

tetraplegjik e cila ishte refuzuar, pasi bazuar në vlerësimin e Komisionit Mjekësor më dt.25.11.2022 nga mjekët specialist është konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për njohjen e këtij kompensimi. Tutje ka shtuar se organi i shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore përkatësisht nenit 8 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-067 si dhe rregullores nr.07.2017 neni 5 par.1.2 dhe 1.3 dhe nenit 6 par.1.2, duke shtuar se arsyetimi i vendimit është kontradiktor me Ligjin për personat paraplegjik dhe tetraplegjik pasi në par.1 të nenit 8, parashihet e drejta e përfituesve sipas këtij ligji, për një kujdestar personal, të cilët kompensohen njëjtë sikurse edhe përfituesit sipas këtij Ligji. Tutje ka shtuar se komisioni vlerësues ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, pasi sipas raporteve mjekësore dhe gjendjes faktike, paditësja ka aftësi të kufizuar të plotë dhe të përhershme pasi ka humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve e cila është në përputhshmëri me raportet mjekësore të bashkangjitura si dhe vendimit të dt.14.03.2018 sipas të cilit rezulton se paditësja ka qenë përfituese e këtij pensioni. Tutje ka propozuar që si shoqërues i saj të jetë babai i saj S.T i cili do ta shoqëroj gjatë udhëtimeve, vizitave mjekësore, pasi nuk është në gjendje që asnjë lëvizje vet pa ndihmën e babait të saj. I ka propozuar gjykatës që të aprovoj kërkesëpadinë dhe të anulohet vendimi kontestues i të paditurës dhe paditëses ti njihet e drejta ne pension për personat paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë.

E paditura, përmes përgjigjes në padi të parashtruar në këtë gjykatë më 24.09.2024, e ka kontestuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Tutje ka shtuar se, organi i shkallës së parë i kishte njohur paditëses të drejtën për kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të II-të, ndërsa me rastin e rivlerësimit, Komisioni Mjekësor ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet për vazhdimin e të drejtës në kompensim për persona paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të I-rë, sepse gjendja shëndetësore e paditëses nuk është në harmoni me nenin 7 par.1 dhe 2 si dhe nenin 8 të Ligjit 05/L-067. Tutje ka shtuar se këshilli i ankesave si organ i shkallës së dytë, duke vepruar sipas ankesës së paditëses ka shqyrtuar në tërësi shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor, dhe vlerësimin e Komisionit Mjekësor të shkallës së parë, dhe ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për kompensim, andaj ankesa është refuzuar si e pabazuar. Më tej ka theksuar se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi, përderisa pala paditëse pretendimet e saj nuk i ka bazuar në asnjë provë të vetme, andaj i ka propozuar gjykatës që s që të refuzoj në tërësi si të pabazuar padinë e paditëses dhe të lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm dhe të drejtë.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 03.12.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: Vendimin e dt.06.12.2022 nga MFPT-DP, Dosjen e kërkesë për personat paraplegjik dhe tetraplegjik dt.11.08.2017, Raportin e komisionit vlerësues për njohjen e statusit me te drejtat E Personave paraplegjik tetraplegjik për D.T 6 faqe (dt.09.03.2018,14.08.2020,20.10.2020),Vendimin nga MPMS-DP dt.15.09.2020, Vendimin MPMS dt.14.03.2018, Dorëzimin e Vendimit nr. lendes 2207 dt.23.09.2020, Vendimin 04.11.2020 nga MPMS-DP, Ankesen e dt. 09.08.2022.(mungon faqja e pare), Kopjen e letërnjoftimit e RKS për S.T, Ekstrakte nga regjistri qendrore i gjendjes civile E21796266 dt.11.08.2017, Deklaratën nga S.T nr.3769/2017, kopjen e letërnjoftimit e RKS D.T, Ekstraktin nga regjistri qendrore i gjendjes civile E21729125 dt.26.07.2017, Vërtetimin e dt.26.07.2017 lidhur me obligimit tatimore, Transaksion nr,37877, Dosjen e kërkesë për personat paraplegjik dhe tetraplegjik-riaplikim nr.03/1554, Vendimin MFPT 06.12.2022, Raportin nga komisioni vlerësues per njohjen e statusit te drejtave për personat paraplegjik dhe tetraplegji 6 faqe (dt.15.06.2022, 25.11.2022), Vendimin nga MFPT 15.09.2020, Raportin nga Konsulta nr.regjistrin 0127 dt.19.11.2021, dt.18.02.2022 nr.regjistrin 288/2022, nr.regjistrin 831, dt.06.04.2022, 06.04.2022, 16.01.2023, dt.16.01.2023 nr,regjis 77, Raportin specialistik nga ordianca euromed Peje dt.02.04.2021, Fletëregjistrimin 08.04.2022, |Udhëzimin për konsultim nr.0007083 dt.04.02.2022, nr.0007915 dt.11.01.2023, nr 0007917 dt.11.01.2023, nr007916 dt.11.01.2023, Qarkullimin për llogari nga BPB dt.04.04.2022, Deklaratën për shoqërim dhe përkujdesje LRP nr.rendor 3351/2022 dt.06.04.2022, Vërtetimin Tatimor dt.04.04.2022 ,Ekstraktin nga regjistri qendrore i gjendjes civile E26021692 dt.04.04.2022, Kërkesën për njohjen e statusit te personave paraplegjik tetraplegjik dt.06.04.2022,Vërtetimin nga HENDIKOS ISTOG nr003012023 dt.16.01.2023,Vërtetimin nga HENDIKOS ISTOG NR011/004/2020 dt.20.11.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar për këto arsye:

Nga provat shkresore të administruara në këtë konflikt administrativ, rezulton se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve, me vendimin e datës 14.03.2018, i kishte miratuar paditëses kërkesën për njohjen e të drejtës në kompensim për personat paraplegjik dhe Tetraplegjik Grupi i II , nga data 11.08.2017 në shumën mujore 150.00 Euro.

Me vendimin e të paditurës të dt.15.09.2020 pas rivlerësimit ishte refuzuar e drejta e paditëses për kompensim të personave paraplegjik dhe tetraplegjik, me arsyetimin se në procedurën e rivlerësimit Komisioni Mjekësor i përbërë nga mjekët specialist, më dt.14.08.2020 përsëri ka shqyrtuar shkresat e lëndës sa i përket gjendjes shëndetësore të paditëses dhe ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për vazhdimin e të drejtës për kompensim të personave paraplegjik dhe tetraplegjik .

Me vendimin e datës.06.12.2022 e paditura ka refuzuar ankesën e paditëses për kompensim për persona Paraplegjik dhe Tetraplegjik me arsyetimin se bazuar në vlerësimin e Komisionit Mjekësor të dt.25.11.2022, nga mjekët e lëmvive përkatëse ishte konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për kompensim për persona paraplegjik dhe tetraplegjik.

E pakënaqur me vendimin përfundimtar të paditurës, paditësja ka ushtruar padi në gjykatë.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar dhe për të vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditëses, gjykata i'u referua, igji Nr. 05/L -067 Për Statusin Dhe Të Drejtat E Personave Paraplegjik Dhe Tetraplegjik, konkretisht nenit 1 e cili përcakton se *“Me këtë ligj rregullohet statusi dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme të cilët marrin kompensim mujor”*, ndërsa neni 7par.2 i këtij Ligji përcakton:” *Përfituesit e këtij ligji, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, të cilët kanë pasoja të përhershme dhe të plota në inkontinencë, përdorin medikamente në baza ditore, kanë humbje të ndjeshmërisë së plotë të ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të plagëve dekubitare marrin një shumë shtesë prej pesëdhjetë përqind (50%) të kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni”* ndërsa neni 8 pika 1 i këtij Ligji përcakton : *“Kujdestari personal 1. Përfituesve të këtij ligji u njihet e drejta për një kujdestar personal, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, e të cilët kompensohen në shumën e njëjtë sikurse përfituesit e këtij ligji”*. Po ashtu gjykata iu referua edhe Rregullores Nr.07/2017, për Përbërjen, Funksonimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik nenit 1 i të njëjtës, i cili përcakton se *“Kjo Rregullore, ka për qëllim përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësisive të*

Komisionit Vlerësues, për vlerësimin e shkallës së humbjes së përhershme të mundësisë së zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo humbjes së përhershme të mundësisë së zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme dhe të sipërme dhe vlerësimin e nevojave sociale për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe përcaktimin e procedurave për parashtrimin e kërkesave për realizimin e të drejtave të përcaktuara me Ligjin nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik”. Kurse neni 5 i cili rregullon Funkcionin dhe Përgjegjësitë e Komisionit, përcakton se “1.Komisioni Vlerësues ka këto funksione dhe përgjegjësi: 1.1.Ekzaminimin e parashtruesit të kërkesës; 1.2. Vlerësimin e grupimit dhe nevojave sociale të personave paraplegjik dhe tetraplegjik, e cila bëhet duke u bazuar në dokumentet mjekësore, mendimin konziliar nga Klinika e Neurologjisë-QKUK, si dhe ekzaminimit nga ana e Komisionit Vlerësues;1.3. Përfituesit e grupit të parë janë persona me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve; 1.4. Përfituesit e grupit të dytë janë persona që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve;1.5.Përcaktimin e nevojës për edukim dhe arsimin; 1.6. Përcaktimin e nevojës për rehabilitim;1.7. Përcaktimin e nevojës për kujdestar personal”.

Nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe te vleresura një nga një dhe të gjitha së bashku si raportet mjekësore, raportin vlerësues të paditurës, gjykata vëren se paditësja nuk si ka plotësuar kriteret për realizimin e drejtës në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik të Grupit të parë.

Prandaj, mbi bazën e provave të administruara dhe sipas vlerësimit të gjykatës, Komisioni Vlerësues i të paditurës i themeluar me ligj, në mendimin e tij në shkallë të dytë më dt.25.11.2022, është vlerësim i drejtë, meqë paditësja nuk i ka plotësuar kriteret për realizimin e drejtës në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, në pajtim me dispozitat e lartë cituara të Ligjit Nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe Rregullores Nr.07/2017, për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik

Duke qenë se kriter ligjor për njohjen e të drejtës në kompensim për Grupin e parë për persona paraplegjik dhe tetraplegjik, Ligji ka paraparë që e drejta e kompensimit për këtë kategori i

njihet vetëm bazuar në vlerësimin e komisionit vlerësues, rezulton se komisioni vlerësues i të paditurës në raportin e saj të dt. 25.11.2022, ka vlerësuar se paditësja nuk plotëson kushtet ligjore për njohën e të drejtës në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, ndërkaq paditësja me asnjë provë nuk ka arritur të vërtetoj pretendimet e saj se i takon grupit të parë të personave paraplegjik dhe tetraplegjik.

Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave, meqenëse paditësja nuk ka parashtruar ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë mjekësore të re, e as nuk ka prezantuar në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.03.12.2024, për këtë arsye gjykata ia ka falur besimin ekspertëve para organeve administrative se këtu paditësja nuk i ka plotësuar kushtet për realizimin e kompensimit për persona paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë, të lartë cituara të Ligjit nr. 05/L -067.

Kjo gjykatë ka vlerësuar edhe pretendimet e paditëses se komisioni vlerësues e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike, pasi sipas raporteve mjekësore dhe gjendjes faktike, paditësja ka aftësi të kufizuar të plotë dhe të përhershme pasi ka humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve e cila është në përputhshmëri me raportet mjekësore të bashkangjitura si dhe vendimit të dt.14.03.2018 sipas të cilit rezulton se paditësja ka qenë përfituese e këtij pensioni, por si të tilla këto pretendime nuk ishin me ndikim në një vendosje tjetër nga çfarë është vendosur nga e paditura bazuar në vlerësimet e Komisioneve Mjekësore të autorizuara me ligj.

Bazuar në dispozitën e nenit 7 par.1 të LPK-së përcaktohet se:” Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”, ndërsa sipas nenit 319, paragrafi 1 përcaktohet : “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”.

Duke pasur parasysh të mësipërmen, gjykata vlerëson se vendimi kontestues i të paditurës, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka refuzuar ankesën e paditëses.

Mbi këto arsye, kërkesëpadinë e paditëses nuk e aprovoi, sepse sipas vlerësimit të gjykatës, nuk është cenuar ligji në dëm të saj.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi bazuar në nenin 64 të LPK-së

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lart, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.113/23, dt.03.12.2024

G j y q t a r j a

Fllanza Hashani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.